



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:058994  
Datë: 21.02.2024  
Numri i dokumentit: 05355216

KPPP.nr. 881/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Unitas Biosales” SH.P.K, me nr. të biznesit 71131254, me seli në Ferizaj, rr. “12 Qershori” p.n., që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat T.H. nga Prishtina, kundër debitorit “Kastrioti -1” sh.p.k, me nr. të biznesit 71294242, me seli në Lipjan, rr. “Skëndërbeu” duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 395/17 të datës 26.07.2017, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 21.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit “Kastrioti -1” SH.P.K ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 395/17 i datës 26.07.2017, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj në shumën prej 10,000.00 EUR, dhe në këtë pjesë të përmbartimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Kastrioti -1” SH.P.K., ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 395/17 të datës 26.07.2017, lejuar nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, sa i përket detyrimit në vlerë prej 14,900.00 EUR.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me datë 26.07.2017 ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 395/17 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit - faturë nr. 1 e datës 17.03.2017 ashtu që është detyruar debitori, që në emër të borxhit të papaguar

nga fatura e lartcekur, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 24,900.00 EUR (njëzet e katërmijë e nëntëqind euro) duke përfshirë edhe kamatëvonesën ligjore si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj urdhrit përmbarimor duke theksuar se me kreditorin është nënshkruar kontrata e datës 23.12.2016, sipas të cilës palët në hyrje të saj janë pajtuar për termet dhe kushtet e bashkëpunimit, ndërsa kreditori ka lëshuar një faturë në të cilën si përshkrim parashihet “*para marrje avans sipas kontratës nr./0031254 e datës 26.01.2017*” në vlerë prej 24,900.00 EUR, e që realisht kreditori nuk i ka dhënë asgjë debitorit për t'i kërkuar këto mjete nga ai. Ka shtuar se në rastin e kontratës tjetër të datës 23.12.2017, kreditori dhe debitori kanë arritur marrëveshje që kreditori t'i paguaj debitorit shumën prej 20% avans gjë të cilën kreditori nuk e ka bërë, e pastaj debitori ka pasur obligim t'i paguaj shumën prej 10% për furnizim me panela solar. Ndërsa me nenin 11, par.4 debitori ka marrë obligim që t'i paguaj shumën prej 204,194.40 EUR në formë avansi me rastin e fillimit të punimeve nga të dyja palët” gjë e cila nuk është bërë nga kreditori.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke theksuar se faturat mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, dhe e njëjta ka qenë e lëshuar për pagesën e 10% të shumës totale të kontratës së nënshkruar me datë 26.01.2017 me debitorin. Ka shtuar se me nenin 5 të kësaj kontrate është paraparë që “blerësi duhet të bëj pagesë prej 10% me nënshkrimin e kontratës 24,900 EUR andaj ka qenë obligim që debitori fillimisht të bëj këtë pagesë e pastaj kreditori ta filloj punën e tij. Me kërkesë që prapësimi të aprovohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbarimit të refuzohet

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, fillimisht, me aktvendimin PPP.nr. 46/17 të datës 29.05.2018, ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit për shumën prej 14,900.00 EUR ndërsa ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit në vlerë prej 10,000.00 EUR, dhe në këtë pjesë të përmbarimit ka shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 395/17 të datës 26.07.2017.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ac.nr. 1693/19 të datës 14.07.2020, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit dhe ka anuluar aktvendimin PPP.nr. 46/17 të datës 29.05.2018 dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë shkallës së parë. Në arsyetimin e saj, ka sqaruar se kreditori, me parashtrësën e datës 07.06.2018 ka precizuar propozimin për përmbarim, duke

zvogëluar kërkesën e tij nga 24,900.00 EUR në 14,900.00 EUR, dhe në rastin e tillë, kur gjykata e shkallës së parë ka miratuar pjesërisht prapësimin ka shkaktuar kontradiktë në përmbajtjen e dispozitivit të aktvendimit pasi që në rastin e tillë, do të duhej që në mungesë të shkaqeve të prapësimi ta aprovoj në tërësi propozimin e kreditorit, duke mos e bërë kontradiktor këtë pjesë të vendosjes.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, në rivendosje, me Aktvendimin PPP.nr. 40/20 të datës 13.01.2021 ka aprovuar në tërësi ankesën e debitorit dhe ka anuluar në tërësi urdhrin përmbarimor P.nr. 395/17 të datës 26.07.2017, ndërsa propozimin për përmbarim të kreditorit për realizimin në të holla në vlerë prej 24,900.00 EUR e ka refuzuar si të pabazuar. Në arsyetimin e saj ka theksuar se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi nuk mund të konsiderohet si e përshtatshme për përmbarim pasi që sipas kësaj fature nuk është kryer asnjë shërbim nga kreditori për debitorin.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 769/22 të datës 04.04.2023 ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit “Unitas Biosales” SH.P.K ashtu që ka anuluar aktvendimin PPP.nr. 40/20 të datës 13.01.2021 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata, në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe duke marrë për bazë vërejtjet sipas Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 769/22 të datës 04.04.2023, shqyrtoi dhe vlerësoj provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në mbështetje të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pjesërisht i bazuar, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet*

*në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.*

Gjykata, në rastin konkret, konstatoi se nga shuma totale e faturës nr. 01 të datës 17.03.2017 në vlerë prej 24,900.00 EUR, debitori ka përmbushur pjesërisht detyrimin dhe atë në vlerë prej 10,000.00 EUR, fakt ky që vërtetohet nga dëftesa e pagesës nr. 001-17 të datës 23.02.2017, dhe e cila pagesë nuk është kontestuese mes palëve ndërgjyqëse se ka të bëjë me borxhin që derivon nga fatura objekt i këtij përbarimi.

Andaj, në kuptim të nenit 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke anuluar pjesërisht urdhrin përbarimor P.nr. 395/17 i datës 26.07.2017 në vlerën prej 10,000.00 EUR, meqenëse fatura nr. 01 e datës 17.03.2017 është bërë e pa efekt juridik në këtë vlerë për shkak të pagesës së pjesshme nga debitori.

Kurse vendimin mbi përfundimin e procedurës përbarimore për pjesën e anuluar të urdhrin përbarimor, Gjykata e mbështeti në nenin 66.4 të LPP-së i cili përcakton se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore”*.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke lënë në fuqi urdhrin përbarimor P.nr. 395/17 të datës 26.07.2017 në vlerën prej 14,900.00 EUR, pasi që fatura nr. 1 e datës 17.03.2017 në bazë të së cilës është lejuar përbarimi, dhe nga e cila faturë buron detyrimi i lartcekur, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti i detyrimit, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi e debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përbarimit pasi që është e përshtatshme për përbarim.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit se fatura nr. 01 e datës 17.03.2017 nuk është e përshtatshme për përmbardim, kjo pasi që kreditori nuk ka kryer asnjë shërbim për debitorin, dhe se fillimisht kreditori ka qenë i obliguar që t'i paguaj debitorit shumën prej 20% avans gjë të cilën kreditori nuk e ka bërë, e pastaj debitori ka pasur obligim t'i paguaj shumën prej 10% për furnizim me panela solar, por që në rastin konkret, gjykata kufizohet vetëm në vlerësimin e dokumentit të besueshëm mbi bazën e të cilit është lejuar përmbardimi, e në këtë drejtim, duke ekzekutuar pjesërisht detyrimin që rrjedh nga kjo faturë dhe atë pa asnjë kundërshtim apo vërejtje, rezulton se debitori ka qenë në dijeni edhe është pajtuar me borxhin që derivon nga fatura.

Gjykata, pati parasysh pretendimet tjera të paraqitura nga debitori në këtë procedurë, e që ndërlidhen me detyrimet e dyanshme të palëve nga kontrata nr. 26/-11/2-17/00331254, por që në procedurë përmbardimore, gjykata ka tagër të lëshohet vetëm në vlerësimin e elementeve formale të dokumentit të besueshëm mbi bazën e të cilit është lejuar përmbardimi, ndërsa lidhur me pretendimet materialo-juridike për mos përmbushje të kontratës, debitori nuk ka pengesë që të inicioj kontest të rregullt juridik-civil.

Gjykata në fund sqaron se në rastin konkret si organ përmbardues ka vepruar përmbarduesi privat, e rrjedhimisht, çdo kërkesë për precizim të propozimit për përmbardim nga kreditori është dashur të drejtohet tek përmbarduesi privat, kjo në kuptim të nenit 42, par. 1 dhe 2 të LPP-së me të cilin parashihet se *“Propozimi për përmbardim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbardimore pa pëlqimin e debitorit. 2. Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbardim organi përmbardues e përfundon përmbardimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht”*.

Prandaj, parashtresën e datës 07.06.2018 të dërguar nga kreditori pranë gjykatës, me të cilën ka njoftuar se propozimi për përmbardim precizohet në vlerën prej 14,900.00 EUR për që shkak të pagesës së pjesshme të debitorit në vlerë prej 10,000.00 EUR, gjykata e morri për bazë vetëm me rastin e vendosjes sipas prapësimin të debitorit, dhe atë si bazë për shfuqizimin e pjesshëm të urdhrin përmbardimor sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Andaj, në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore si dhe nenit 13

par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 881/23, datë 21.02.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.